



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
GRAMSH

Nr. 298/2 prot

Gramsh, më 29/01/2024

Vendim

Nr. 01, dt. 26.01.2024

Për

Miratimin e kërkesave për bonus të qirasë për disa familje në nevojë ,bazuar në programet sociale për strehimin e banorëve të bashkisë Gramsh me qëllim përfitimin e fondeve buxhetore.

Këshilli i bashkisë Gramsh në mbledhjen e tij të datës 26 01.2024, pasi mori në shqyrtim relacionin e Sektori I Emergjencave Civile dhe Strehimit “Për miratimin e kërkesave për bonus të qirasë për disa familje në nevojë , bazuar në programet sociale për strehimin e banorëve të bashkisë Gramsh me qëllim përfitimin e fondeve buxhetore”, në mbështetje të ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, në VKM nr.459, datë 03.07.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirsë ose uzufuktit,mënyrën e financimit të subvencionit,monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe Ministrisë përgjegjëse për strehimin”,në Udhëzimin e MFE,nr.31,dt.18.11.2019,”Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit, të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015,”Për vetëqeverisjen vendore”,neni 8,pika 2;

Vendos i:

- I. Të miratohet kërkesa për 37 familje në nevojë për bonus të qirasë , bazuar në programet sociale për strehimin e banorëve të bashkisë Gramsh me qëllim përfitimin e fondeve buxhetore.
- II. T’i propozohet Ministrisë përgjegjëse për strehimin alokimi i fondeve në shumën 4 218 420 sipas tabelës bashkëlidhur.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë,Sektori i Emergjencave Civile dhe Strehimit,drejtoria e Buxhetit dhe Financës.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Kryetari i Këshillit të Bashkisë

Enis ZANI